VENDIM
Nr. 49, datë 24.3.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "GREEN ENERGY TRADING ALBANIA" SHPK, NR. 286, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 59, DATË 23.4.2015

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 24.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë "GREEN Energy Trading Albania" sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "GREEN Energy Trading Albania" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 432 prot., datë 13.2.2020, mbërritur në drejtori në datën 20.2.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar. Në datën 25.9.2014, është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", me numër identifikimi (NUIS) L42125016S.
- Në bazë të nenit 16, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Konstatohet se shoqëria "GREEN Energy Trading Albania" sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.
- Aplikimi i shoqërisë "GREEN Energy Trading Albania" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
- Formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b" "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e") është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d"), është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar apo jo të plotë, që ka të bëjë me:

Neni 9, pika 2

Dokumentet juridike, administrative dhe pronësor

- germa "c" (Vërtetimi i regjistrimit dhe ekstrakt historik nga QKB-ja):

- do t'i kërkohet shoqërisë ta plotësojë vërtetimin e regjistrimit pranë QKB-së, në zbatim të kësaj kërkese të rregullores.

- germa "d" (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë):

- do t'i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për administratorin e shoqërisë dhe përfaqësuesin e saj ligjor, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjendjes se epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, në formën e kërkuar nga ligji.

Neni 16, pika 1, germa "c"

Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3

Neni 9, pika 3

- germa "a" (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime)):

- në vijim do t'i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE edhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

Neni 9, pika 4.8

- germa "b" (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie):

Në vijim do t'i kërkohet shoqërisë të bëjë me dije ERE-n, lidhur me kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "GREEN Energy Trading Albania" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë nr. 286, seria T15, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 23.4.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 24.4.2020.

2. Subjekti aplikues ka detyrimin për të paraqitur, jo me vonë se një muaj nga përfundimi i epidemisë Covid-19, vërtetimet e përcaktuara ne nenin 9, germa d, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti